



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 261/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja e Demokratike Kosovës (LDK), dega Mitrovicë, për shkak heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 08.06.2014, subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja e Demokratike Kosovës dega Mitrovicë, me të cilën parashtruesi i ankesës pretendon se në Qendren e votimit nr.1104B në Shkollën Fillore “Ismajl Qemajli” në Komunën e Mitrovicës, rreth orës 17:00, këshilltari i kuvendit komunal të Mitrovicës Festim Kutllovci ka ftuar qytetar të pranishëm në atë lokacion për të votuar për LDK-në.

Parshtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmitarit ka ofruar dy persona me emër dhe mbiemër dhe me nr. të telefonit.

PPZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik- Lidhjen Demokratike të Kosovës -, me datën 09.06.2014, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 10.06.2014 deri në ora 19:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë sipas afatit të caktuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, pretendohen se këshilltari i kuvendit komunal të Mitrovicës Festim Kutllovci para Qendrës së votimit të lart përmendur ka bërë fushatë duke ftuar qytetar të votojnë LDK-në, në ditën e Zgjedhjeve më datën 08.06.2014.

PZAP-i, gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, ngase pohimet e lartcekura nga parashtruesi i ankesës nuk janë objektive, për arsye se PZAP-i ka kontaktuar përmes telefonit dhe ka marr deklaraten nga dëshmitaret e ofruar nga parashtruesi i ankesës të cilët janë simpatizantë dhe mbështetës të subjektit politik Partia Demokratike Kosovës (PDK).

andaj PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

Anr.261/2014 më datën 12.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*